



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT BERAT

Nr. 340/6 Prot.

Berat, më 15.04.2020

Vendim

Nr. 10 Datë 15 / 04 / 2020

“Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Komisionit Këshillimor të Vlerësimit të Figurave në

Këshillin e Qarkut Berat”


Në mbështetje të *Kushtetutës së Shqipërisë* neni 110, LIGJ Nr. 139/2015” *Për Vet qeverisjen vendore*” miratuar në datën 17.12.2015, LIGJ Nr. 112/2013 *Për Dekoratat, Titujt e nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë* (Ndryshuar me ligjin Nr. 10/2015, datë 19.2.2015), VKM nr 861 datë 10.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të hollësishtme për funksionimin e komisioneve Këshillimor për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë*”

Me qëllim përcaktimin e rregullave të funksionimit me efikasitet të veprimitarisë së Komisionit Këshillimor të Vlerësimit të Figurave, për realizimin e funksioneve dhe kompetencave të tij të përcaktuar në aktet ligjore, Komisioni Këshillimor i Vlerësimit të Figurave të Qarkut Berat.

VENDOSI

1. Miratimin e Rregullores së Brendshme të Komisionit Këshillimor të Vlerësimit të Figurave.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni Këshillimor i Vlerësimit të Figurave.

KRYETAR



Ky vendim u miratua me vota pro : 10
Këshilltar gjithsej : 18
Marrin pjesë në votim ; 10

Kreu I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore të Brendëshme është njohja e përkushtimit ndaj, interesave të shoqërisë, nëpërmjet përcaktimit të rregullave për vlerësimin e personave me merita dhe kontribut të veçantë për Qarkun Berat si dhe shpërblimin e tyre.

Neni 2

Baza Ligjore

Kushetuta e Shqipërisë neni 110, LIGJ Nr. 139/2015” *Për Vet Qeverisjen Vendore*” miratuar në datën 17.12.2015, LIGJ Nr. 112/2013 *Për Dekoratat, Titujt e nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë* (Ndryshuar me ligjin nr.10/2015, datë 19.2.2015), *VKM nr 861* datë 10.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve Këshillimor për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë*”

Neni 3

Objekti

Objekt i kësaj rregullore është përcaktimi i, rregullave, procedurat dhe kriteret për propozimin, shqyrtimin, dhënien e titullit vendor “Nderi Qarkut”, që jepet në Këshillin e Qarkut nga Autoriteti Përgjegjës.

Neni 4

Parimi i përgjithshëm

1. Dhënia e Titullit të "Nderi Qarkut", udhëhiqet nga parimi i vlerësimit të kontributit, meritokracisë, transparencës dhe mirënjohjes publike.
2. Përfitimi i "Titulli Nderi", nuk është një e drejtë dhe nuk mund të kërkohet si e tillë, në rrugë individuale apo institucionale.
3. Personi që ka marrë një dekoratë me të larte nuk mund të përfitojë më vonë në kohë një titullin "Nderi I Qarkut ".

Neni 5

Shpërblimi

1. Dhënia e titullit të nderit, nuk shoqërohet me një shpërblim financiar nga autoritetit përgjegjës.
2. Efektet financiare përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për autoritetin përgjegjës përkatës.

KREU II

TITULLI VENDORË "NDERI I QARKUT"

Neni 6

1. Titulli i Nderit jepet me synim shpërblimin e akteve të veçanta, merite apo trimërie, çdo personaliteti shqiptar ose të huaj për veprimtari të shquar në dobi të qarkut përkatës apo për veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të tij në rang Qarku .

2. Kryetari i Këshillit të Qarkut është i vetmi autoritet që jep titullin nderi në nivel Qarku.

Neni 7

1. Titulli vendor i nderit jepet për shpërblimin e veprimtarisë së shquar brenda juridiksionit të njësive të qeverisjes vendore ose për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të komunitetit brenda territorit vendor.
2. Titulli përbëhet nga motivacioni i shoqëruar me një certifikatë, me logon e Qarkut .

Neni 8

Autoritetet përgjegjëse

1. Autoriteti përgjegjëse për dhënien e titullit vendorë të nderit është Këshilli i Qarkut.
2. Titulli vendorë I nderit jepet, kryesisht, ose me propozimin e:
 - a) Komisionit të vlerësimit të figurave
 - b) Çdo anëtari të Këshillit të Qarkut.
 - c) Kryetarit të Këshillit të Qarkut.

KREU III

PROCEDURA E DHËNIES SË TITULLIT VENDOR TË NDERIT TË QARKUT

Neni 9

Komisioni Këshillimor

1. Autoriteti përgjegjës për dhënien e titullit të nderit, krijon pranë tij një komision këshillimor, të përbërë prej 5 anëtarësh, ku 3 anëtarë duhet të jenë punonjës nën varësinë e tij dhe 2 anëtarët e tjerë personalitete të jashtme, të cilët zgjidhen me propozim të anëtarve të Këshillit të Qarkut.
2. Të gjitha propozimet për dhënien e titullit të nderit i dërgohen autoritetit përgjegjës për dhënien e tyre, i cili i përcjell menjëherë për vlerësim në komisionin këshillimor.

3. Komisioni këshillimor fillon shqyrtimin e te gjithë dokumentacionit të mbërritur pranë ketij organi nëse përmbushen apo jo kriteret e cituara në kreu V ,neni 12.
4. Mbledhjet e komisionit këshillimor zhvillohen kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij.

KREU IV

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT KËSHILLIMOR

Neni 10

1. Komisioni funksionon si organ kolegjal, vendimmarrës, pranë autoritetit përgjegjës për dhënien e medaljeve apo titujve vendorë të nderit.
2. Komisioni, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh, me shumicë votash, kryetarin dhe sekretarin e tij.
3. Kryetari drejton mbledhjen, drejton diskutimet, siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.
4. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen brenda 10 (dhjetë) ditëve, pas paraqitjes së kërkesës dhe, të paktën, 48 orë para datës së thirrjes së mbledhjes.
5. Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të tregojë, në mënyrë të qartë dhe të detajuar, çështjet për të cilat do të diskutohet, orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes.
6. Mbledhja është e vlefshme edhe kur nuk respektohen procedurat e parashikuara më sipër, vetëm në rast se në atë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët, të cilët, paraprakisht, miratojnë zhvillimin e mbledhjes.
7. Mbledhjet e komisionit zhvillohen kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij.

KREU V

VENDIMMARRJA DHE MËNYRA E VOTIMIT

Neni 11

1. Komisioni shqyrton propozimet dhe merr vendimin me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Votimi është i hapur.
2. Anëtarët e komisionit, që janë të pranishëm në mbledhje, nuk mund të abstenojnë.
3. Kryetari i organit kolegjal voton i fundit.
4. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, në të cilin pasqyrohen data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që marrin pjesë, çështjet që diskutohen, vendimet e marra, si dhe mënyra dhe rezultati i votimeve.
5. Procesverbali mbahet nga sekretari dhe duhet t'u paraqitet, për miratim dhe nënshkrim, të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse.
6. Në rastet kur vetë organi e shikon të arsyeshme dhe mbledhja është e ndarë në seanca, procesverbali miratohet menjëherë pas përfundimit të seancës përkatëse.
7. Anëtarët mund të kërkojnë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsytet e votimit kundër një vendimi.
8. Procesi i shqyrtimit të propozimit mund të shtyhet apo të pezullohet përkohësisht, për rrethana të paparashikuara, që dëmtojnë reputacionin e titullit vendor të nderit në opinionin publik, deri në sqarimin e këtyre rrethanave. Arsyet e shtyrjes apo të pezullimit, si dhe afati, pasqyrohen në procesverbal.
9. Kur propozimi për dhënien e medaljes apo titullit vendor të nderit nuk miratohet, komisioni njofton autoritetin propozues për mosmiratimin. Në çdo rast, vendimi i arsyetuar dhe procesverbali i mbledhjes i përcillen autoritetit përgjegjës për miratimin e propozimit.
10. Në rast se propozimi miratohet nga autoriteti përgjegjës, urdhi ose vendimi i dërgohet komisionit për përgatitjen e çertifikatave përkatëse, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit.
11. Komisioni ndjek procedurën e përgatitjes së çertifikatave përkatëse. Pas përgatitjes së tyre, komisioni njofton autoritetin propozues për organizimin e ceremonisë për dhënien e titullit të nderit, medaljes si dhe për programin, kohën dhe vendin ku do të zhvillohet ceremonia.

**Propozimi për dhënien e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve
dhe titujve vendorë të nderit**

1. Propozimi duhet të dërgohet jo më vonë se 90 ditë kalendarike përpara datës së propozuar për dhënien e dekoratës, titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit, me përjashtim të rasteve të veçanta kur respektimi i këtij afati është bërë objektivisht i pamundur.
2. Në aktin e propozimit përcaktohen:
 - a) autoriteti propozues dhe baza ligjore për propozimin;
 - b) emri, mbiemri dhe prezantimi i personit të propozuar;
 - c) arsyet e hollësishme që çojnë në propozimin e personit;
 - ç) lloji i dekoratës, titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit;
 - d) elementet që vërtetojnë përmbushjen e kritereve përkatëse për dhënien e dekoratës, titullit të nderit, medaljes ose titullit vendor të nderit;
 - dh) vërtetimi se personi i propozuar nuk është dënuar ndonjëherë për shkelje të rënda të ligjit ose nuk është nën hetim;
 - e) në rastin e Titullit “Nderi I Qarkut”, vërtetim se personit të propozuar nuk i është dhënë më parë një dekoratë e njëjtë ose më e lartë se ajo e propozuar.

Shqyrtimi i propozimit

1. Komisioni këshillimor verifikon nëse akti i propozimit përmban të gjitha elementet e kërkuara kjo rregullore.
2. Nëse propozimi nuk është i plotë, komisioni këshillimor kërkon me shkrim, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së propozimit, plotësimin e tij nga autoriteti propozues. Plotësimi i propozimit bëhet jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga data e marrjes së njoftimit.
3. Nëse propozimi është i plotë, komisioni këshillimor paraqet mendimin e tij pranë autoritetit përgjegjës brenda 30 ditëve nga data e marrjes së propozimit.

4. Procedurat për shqyrtimin se titulli nderi nuk mund të zgjasin më shumë se 60 ditë kalendarike.

5. Procesi i shqyrtimit të propozimit mund të shtyhet apo të pezullohet përkohësisht për rrethana të paparashikuara, që dëmtojnë reputacionin dhe vlerën e aktit të dekorimit, dhënies së titullit të nderit, në opinionin publik, deri në sqarimin e këtyre rrethanave.

Neni 14

Miratimi i propozimit

1. Propozimi miratohet:

- a) me vendim Këshilli, në rastin e titullit vendorë të” Nderi të Qarkut”
- 2.Në rast se propozimi miratohet, vendimi i dërgohet komisionit këshillimor, me qëllim e përgatitjes së certifikatës përkatëse.
3. Pas përgatitjes së certifikatës përkatëse, komisioni këshillimor njofton autoritetin propozues për miratimin e propozimit dhe njofton për organizimin e ceremonisë për dhënien e titullit vendor të nderit, duke dërguar të dhëna për programin, kohën dhe vendin ku do të zhvillohet ceremonia.

Neni 15

Refuzimi i propozimit

1. Kur propozimi për dhënien e titullit vendor të nderit nuk miratohet, komisioni këshillimor i bën njoftimin autoritetit propozues për mosmiratimin.
2. I njëjti propozim nuk mund të bëhet pa kaluar 1 vit kalendarik nga njoftimi i refuzimit të propozimit

Neni 16

Organizimi i ceremonisë

1. Ceremonia e dhënies së titullit vendorë të nderit organizohet nga autoriteti që ka bërë propozimin, në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës për dhënien e tyre.
2. Dhënia e titullit vendorë të nderit bëhet në çdo rast me ceremoni, e cila mund të jetë publike ose jopublike, sipas vlerësimit të autoritetit përgjegjës.
3. Ceremonia e dhënies së titullit vendor të nderit bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga miratimi i tij/i saj.
4. Si rregull, titujve vendorë të nderit është e lidhur me përvjetorë e ngjarje të rëndësishme historike e aktuale, si dhe me festat kombëtare.
5. Dekoratën, titullin vendor të nderit e jep autoriteti përgjegjës ose një person i autorizuar prej tij.
6. Titulli vendor i nderit i jepet vetë personit. Në rast se nderimi bëhet pas vdekjes, dekorata, titulli i nderit, medalja ose titulli vendor i nderit u jepet familjarëve më të afërt të personit.
7. Në raste të veçanta, për personalitete me merita shumë të spikatura, ceremonia organizohet në selinë e autoritetit përgjegjës dhe titulli vendor i nderit jepet nga titullari i këtij autoriteti .
8. Çasti i dorëzimit të titullit vendor të nderit mund të shtyhet apo të pezullohet përkohësisht, nëpërmjet të njëjtit akt, me të cilin është dhënë fillimisht, për rrethana të paparashikuara, që dëmtojnë reputacionin dhe vlerën e këtij aktit në opinionin publik, deri në sqarimin e këtyre rrethanave.

Neni 17

Dispozita e fundit

Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi me miratimin e Këshillit të Qarkut Berat, dhe çdo ndryshim është e detyrueshme të miratohet në Këshill.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT BERAT
KOMISIONI KËSHILLIMOR

Berat, më 09.07.2020

RELACION

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT KËSHILLIMOR TË
VLERËSIMIT TË FIGURAVE TË SHQUARA NË KËSHILLIN E QARKUT BERAT.

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Qarkut Berat,

Rregullorja e Funkcionimit të Komisionit Këshillimor të Vlerësimit të Figurave të Shquara të Qarkut Berat përcakton kornizën e rregullave të funksionimit të veprimtarisë së Komisionit Këshillimor të Vlerësimit të Figurave të Shquara të Qarkut Berat të ngritur me Vendimin nr. 6, datë 20.02.2020, miratuar nga anëtarët e Këshillit të Qarkut Berat, konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr. 181 /1Prot.,datë 28.02.2020.

Kjo rregullore ka për objekt krijimin e një kuadri rregullator për funksionimin me efikasitet të veprimtarisë së Komisionit Këshillimor.

Hartimi i kësaj rregulloreje është propozuar nga anëtarët e tij në mbledhjen e parë të zhvilluar nga ky komision në datë 29.06.2020.

Rregullorja e propozuar përbëhet nga këta kapituj:

Kreu I : Dispozita të Përgjithshme

Në këtë kapitull trajtohet objekti, qëllimi, baza ligjore, parimi i përgjithshëm dhe shpërblimi mbi dhënien e Titujve të Nderit.

KREU II : Titulli Vendorë “Nderi i Qarkut”

Në këtë kapitull trajtohen Titujt e Nderit dhe Autoriteti Përgjegjës për dhënien e tyre.

KREU III: Procedura e Dhënies së Titullit Vendor të Nderit të Qarkut
Në këtë kapitull trajtohen mënyra e krijimit dhe kopetencat e Komisionit Këshillimor

KREU IV: Organizimi dhe Funksionimi i Komisionit Këshillimor
Në këtë kapitull trajtohet mënyra e funksionimit të Komisionit Këshillimor.

KREU V: Vendimmarrja dhe Mënyra e Votimit
Në këtë kapitull trajtohet shqyrtimi, vendimmarrja, organizimi i ceremonisë në rast miratimi si dhe dispozitat e fundit mbi hyrjen në fuqi dhe ndryshimet në rregullore.

KOMISIONI KËSHILLIMOR

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Evis Plaku

Hyrije Zeqaj

Besjana Liçaj

